

VENDIM
Nr. 206, datë 10.4.2019

PËR PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR “EXPO 2020 DUBAI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen e Shqipërisë në Panairin Ndërkombëtar “EXPO 2020 DUBAI”.
 2. Shqipëria të përfaqësohet nga Komisari i Përgjithshëm i Shqipërisë, i cili nënshkruan kontratën e pjesëmarrjes në Panairin Ndërkombëtar “EXPO 2020 DUBAI”, i udhëhequr nga tema kryesore e panairit “Bashkojmë idetë, krijojmë të ardhmen”.
 3. Ngritjen e grupit të punës për organizimin dhe pjesëmarrjen e Shqipërisë në Panairin Ndërkombëtar “EXPO 2020 DUBAI”, i cili do të kryesohet nga drejtori i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:
 - Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
 - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
 - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
 - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
 - Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
 - Ministria e Kulturës;
 - Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
 - Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.
 4. Objekti i veprimtarisë së grupit të punës të jetë si më poshtë vijon:
 - përcaktimi i tematikës së pavijonit të Shqipërisë;
 - përzgjedhja e Ditës Kombëtare të Shqipërisë;
 - përcaktimi i kalendarit të aktiviteteve sipas çdo institucioni;
 - përcaktimi i listës së pjesëmarrësve sipas kalendarit të aktiviteteve;
 - përllogaritja e kostove administrative për pjesëmarrjen e çdo institucioni në panair.
 5. Autorizohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për menaxhimin dhe administrimin e pavijonit shqiptar në Panairin Ndërkombëtar “EXPO 2020 DUBAI”, si dhe të veprimeve financiare nën mbikëqyrjen e grupit të punës, kryesuar nga Komisari i Përgjithshëm i Shqipërisë.
 6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Komisari i Përgjithshëm i Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe